



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronjat g), m), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 2 paragrafi 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neneve 14 dhe 19 paragrafët 1.7 dhe 1.13 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në kuadër të masave për parandalimin dhe luftimin e Corona virusit COVID-19 si formë e mbështetjes për qytetarët dhe subjektet afariste në territorin e Komunës së Podujevës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 02 prill 2020, miratoi këtë;

VENDIM PËR LIRIMIN NGA PAGESA E QIRASË PËR TË GJITHË SHFRYTËZUESIT E PRONËS KOMUNALE

Neni 1

Me këtë vendim, lirohen nga pagesa e qirasë të gjithë shfrytëzuesit e pronës së Komunës së Podujevës.

Neni 2

Lirimi nga pagesa e qirasë sipas nenit 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të mbështetjes së subjekteve afariste për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Corona Virus COVID-19.

Neni 3

Zbatimin e Vendimit e bëjnë Drejtoritë e Administratës komunale, varësisht fushveprimtarisë dhe kompetencave përkatëse.

Neni 4

Ky vendim ka efekt juridik nga data e hyrjes në fuqi deri më 31.12.2020.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-016/01-0020195/20
Podujevë,
02 prill 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi